

**FEDERATA E BOKSIT
E KOSOVËS**



**BOXING FEDERATION
OF KOSOVA**

Tel/Fax: +383 38 247 578; Mob: +383 44 112824,44 208 215 E-mail: fboxk@hotmail.com
Adress: Str. Agim Ramadani no: 43, House of Sport I floor no3, 10000 Pristina, Kosova
NLB Bank No: 1701001010850503

Në bazë të nenit 26 nenpika 2 e statutit të FBOXK në mbledhjen e anëtarve të kuvendit të mbajtur me 05.05.2022 miratoj :

RREGULLORËN

MBI ORGANIZIMIN E PUNËS SË KUVENDIT TË FEDERATËS SË BOKSIT TË KOSOVËS

Prishtinë 05.05.2022

**FEDERATA E BOKSIT
E KOSOVËS**



**BOXING FEDERATION
OF KOSOVA**

Tel/Fax: +383 38 247 578; Mob: +383 44 112824,44 208 215 E-mail: fboxk@hotmail.com
Adress: Str. Agim Ramadani no: 43, House of Sport I floor no3, 10000 Pristina, Kosova
NLB Bank No: 1701001010850503

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet organizimi dhe mënyra e punës së Kuvendit të Federates së Boksit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi i Federates).

Neni 2

Kuvendin e Federates e përbëjnë delegatet e klubeve të boksit nga 1 (një) delegat Kryetari i klubit dhe një sipas zgjedhjes së klubit.

Perberja për mbledhjen e Kuvendit është 34 delegat e prej të cilëve 3 janë femra dhe 1 nga bashkësitë e pakicave etnike.

Neni 3

Puna e Kuvendit të Federates realizohet në mbledhjet e rregullta të punës dhe zgjedhore.

Mbledhjet e rregullta të punës së Kuvendit të Federatës mbahen një herë në vit, sipas rregullit në

fillim të çdo viti kalendarik.

Mbledhjet zgjedhore të Kuvendit të Federates së Boksit të Kosovës mbahen në çdo 4 vite dhe atë më se voni 30 ditë pas skadimit të mandatit të anëtarëve të Kuvendit.

Emrimet dhe shkarkimet e Kryetarit dhe organeve tjera bëhen në bazë të nenit 18 të kësaj rregullore.

II. PËRGADITJA DHE THIRRJA PËR MBLEDHJE TË KUVENDIT

Neni 4

Thirrja për mbledhjen e Kuvendit të Federates së Boksit me propozimin e rendit të ditës dhe materialin gjegjës, iu dërgohet anëtarëve të Kuvendit më se voni 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes.

Neni 5

Mbledhja e Kuvendit të Federates së Boksit mund të mbahet nëqoftëse në mbledhje marrin pjesë më shumë se 50%+1 e anëtarëve të Kuvendit të Federates.

Në rast se vërtetohet se në mbledhje nuk marrin pjesë numri i duhur i anëtarëve, mbledhja e Kuvendit të Federates së Boksit shtyhet dhe e njëjta thirret në afatin prej 10 ditëve.

**FEDERATA E BOKSIT
E KOSOVËS**



**BOXING FEDERATION
OF KOSOVA**

Tel/Fax: +383 38 247 578; Mob: +383 44 112824,44 208 215 E-mail: fboxk@hotmail.com
Adress: Str. Agim Ramadani no: 43, House of Sport I floor no3, 10000 Pristina, Kosova
NLB Bank No: 1701001010850503

III. UDHËHEQJA E PUNËS DHE VENDOSJA NË MBLEDHJET E KUVENDIT

Neni 6

Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Federates se Boksit e udhëheqë Kryetari i Federates , ose në mungesë të tij personi të cilin ai e cakton.

Mbledhjet zgjedhore të Kuvendit të Federates se Boksit i udhëheqë Kryesia e punës, e cila zgjedhet në mbledhjen e Kuvendit të Federates.

Kryesinë e punës e propozon dhe të njëjtën e udhëheqë Kryetari i Federates i përbërjes së gjërtanishme, deri në zgjedhjen e Kryetarit të ri.

Neni 7

Para fillimit të mbledhjes, Komisioni zgjedhor vërteton numrin e anëtarëve të Kuvendit që janë prezent dhe që mungojnë dhe njofton të pranishmit se në mbledhje prezentojnë numër i duhur i anëtarëve për marrjen e vendimeve të plotëfuqishme.

Neni 8

Në mbledhjen zgjedhore të Federates e Boksit para caktimit të rendit të ditës, zgjedhet Kryesia e punës, Komisioni për verifikimin e anëtarëve të Kuvendit, Komisioni zgjedhor dhe kandidues, procesmbajtësi dhe verifikuesi të tij.

Neni 9

Në mbledhjen zgjedhore të Federates se Boksit, marrine pjese me te drejte vote vetem delegatet e caktuar ne baz te nenit 2 të kesaj regullore.

Neni 10

Kryetari i Federates se Boksit, në pajtim me rendin e ditës të propozuar në thirrjen për mbledhjen e Kuvendit, e hapë diskutimin për rendin e ditës, dhe pas kesaj e aprovon ate.

Neni 11

Anëtarët e Kuvendit kanë të drejtë të marrin pjesë në diskutim për të gjitha pikat e rendit të ditës, të shtrojnë pyetje të kërkojnë skjarime dhe përgjigje.

Neni 12

Shqyrtimi mbi pikat e veçanta të rendit të ditës udhëheqet sipas regullit, së pari në parim, e pastaj në veçanti, gjegjësisht sipas pjesëve.

FEDERATA E BOKSIT E KOSOVËS



BOXING FEDERATION OF KOSOVA

Tel/Fax: +383 38 247 578; Mob: +383 44 112824,44 208 215 E-mail: fboxk@hotmail.com
Adress: Str. Agim Ramadani no: 43, House of Sport I flour no3, 10000 Pristina, Kosova
NLB Bank No: 1701001010850503

Mënyrën e udhëheqjës së shqyrtimit e propozon Kryetari. Kryetari mund të propozojë që koha e shqyrtimit të diskutimit të kufizohet .

Neni 13

Nëse është e nevojshme që mbi disa çështje të veçanta të shqyrtohet dhe të vendoset, atëherë duhet të bëhet skjarimi hyrës. Kryetari i Federates se Boksit do të caktojë raportuesin, i cili në pika të shkurtëra do të paraqesë pjesën hyrëse dhe do të japë arësytimet. Kryetari mund që gjatë shqyrtimit të kërkojë që raportuesi ose përpunuesi i materialit, të japë skjarime plotësuese.

Neni 14

Anëtarët e Kuvendit të Federates se Boksit, gjegjësisht personat tjerë, të cilët janë të thirrur në mbledhje, marrin pjesë në diskutime sipas rendit të paraqitur.

Kryetari mund t'i japë fjalën pa rend raportuesit apo personit tjetër të thirrur, kur vlerëson të nevojshme për skjarime plotësuese, apo për plotësimin e propozimit për të cilin diskutohet.

Neni 15.

Askush nuk mund të merr pjesë në diskutim para se t'ia jap fjalën Kryetari, të ndërhyjn në fjalë pjesëmarrësit në diskutim, apo ndonjë mënyrë tjetër të pengojë punën e Kuvendit.

Kryetari ka të drejtë që personi i cili e pengonë punën normale të mbledhjes, t'i apë vërejtje, t'ia marrë fjalën, e në raste të prishjes së rendit të ditës, ta largojë nga mbledhja.

Neni 16

Diskutimi sipas pikave të rendit të ditës, sipas rregullës zgjatë deri sa të mbarojnë diskutimet e të gjithë të paraqiturve.

Kryetari mbyllë diskutimin dhe propozonë që të kalohet në vendosje.

Në bazë të propozimeve dhe mendimeve të paraqitura në diskutime dhe propozimeve në material, Kryetari apo raportuesi i formulonë, rezymet apo vendimet dhe të njëjtat i paraqet në votim.

Neni 17

Mbi propozimet vendoset me votim, i cili mund të jet i hapur apo i fshehtë, mbi të cilën mënyrë vendosë Kuvendi i Federates se Boksit.

Votimi i hapt bëhet me ngritjen e dorës, ndërsa rezultatet e votimit vërtetohen me numrim.

Votimi i fshehtë bëhet me fletëza. rezultatet e votimit të fshehtë i vërtetonë Komisioni verifikues, të cilin e formonë Kuvendi i Federates se Boksit në fillim të mbledhjes.

FEDERATA E BOKSIT E KOSOVËS



BOXING FEDERATION OF KOSOVA

Tel/Fax: +383 38 247 578; Mob: +383 44 112824,44 208 215 E-mail: fboxk@hotmail.com
Adress: Str. Agim Ramadani no: 43, House of Sport I floor no3, 10000 Pristina, Kosova
NLB Bank No: 1701001010850503

Vendimi konsiderohet i aprovuar, nëse për atë deklarohen më shumë se gjysma e anëtarëve prezent.

IV. ZGJEDHJA E ORGANEVE TË FEDERATES SKITARE TE KOSOVES

Neni 18

Në mbledhjen zgjedhore të Kuvendit të Federates se Boksit, verifikohet mandati dhe zgjedhën organet:

- Kryetari i Federates se Boksit,
- Bordi dhe
- Këshilli Mbikëqyrës

Shkarkimin e këtyre organeve e bënë Kuvendi i Federates se Boksit të Kosovës për shkak të mosëkryerjes së detyrave ,mosërespektimit të Statutit të Federates se Boksit të Kosovës,dhe ligjit të Sportit.

Neni 19

Verifikimin e mandatit të anetareve te posazgjedhur e vërtetonë Kuvendi në bazë të raportit të Komisionit verifikues.

Komisioni verifikues përbëhet prej 3 anëtarëve të zgjedhur në Kuvend.

Neni 20

Tetë (8) anëtar të Këshillin Drejtues zgjdhen në propozim të anëtarëve të Kuvendit,Kurse dy (2) nënkryetar të Këshillit Drejtues i emronë Kryetari i Federates se Boksit, Këshillin Mbikëqyrës e zgjedh Kuvendi në bazë të propozimeve të anëtarëve të Kuvendit.

Neni 21

Komisionet e nevojshme për kryerjen e punëve të caktuara i zgjedhë Këshilli Drejtues i posazgjedhur në mbledhjet e veta pas Kuvendit.

V. PROCESVERBALET

Neni 22

Ne mbledhjet e Kuvendit të Federates se Boksit, udhëheqet procesverbali.

Procesmbajtësin dhe verifikuesin e prçesverbalit e propozon Kryesia e punes te Kuvendit te Federates se Boksit.

Neni 23

Procesverbali mbi punën e Kuvendit përmbanë të dhënat themelore, dhe këtë:

FEDERATA E BOKSIT E KOSOVËS



BOXING FEDERATION OF KOSOVA

Tel/Fax: +383 38 247 578; Mob: +383 44 112824,44 208 215 E-mail: fboxk@hotmail.com
Adress: Str. Agim Ramadani no: 43, House of Sport I floor no3, 10000 Pristina, Kosova
NLB Bank No: 1701001010850503

- ditën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes,
- shenjen dhe numrin e mbledhjes,
- numrin e anëtarëve të Kuvendit prezent dhe joprezent,
- personat tjerë prezent,
- emrin e Kryesuesit, emrin e procesmbajtësit dhe verifikuesit të procesverbalit,
- rendi i ditës,
- emrat e pjesëmarrësve në diskutime me përmbatje të shkurtër të diskutimeve,
- rezultatet e votimit sipas pikave të veçanta të rendit të ditës,
- mendimet e ndara të anëtarëve në Kuvend dhe çështjet tjera me rëndësi.

Në fund të çdo pike të rendit të ditës shenohet përfundimi sipas rendit të formulimit, ashtu si e ka paraqitur Kryetari.

Neni 24

Procesverbali përpunohet në origjinal dhe në numër të mjaftueshëm të përshkrimit. Procesverbalin origjinal e nënshkruan Procesmbajtësi, verifikuesi i procesverbalit dhe Kryetari i Federates së Boksit dhe i njëjti me materialin tjetër ruhet në arkivin e Federates së Boksit.

VI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 25

Çështjet të cilat nuk janë përfshir me këtë Rregullore, rregullohen me vendime të veçanta, të cilat i bie Kuvendi i Federates së Boksit në bazë të Statutit.

Neni 26

Kjo Rregullore hynë në fuqi në ditën e aprovimit dhe zbatohet në Kuvendin, në të cilin është aprovuar

Neni 27

Me ditën e Hyrjes në fuqi të kësaj Rregullorje, pushon të vlejë rregullorja nga Kuvendi i kaluar i Federates së Boksit të Kosovës.

Kryetari i FboxK-së
Enver Krasniqi



Prishtinë më 05.05.2022

**FEDERATA E BOKSIT
E KOSOVËS**



**BOXING FEDERATION
OF KOSOVA**

Tel/Fax: +383 38 247 578; Mob: +383 44 112824,44 208 215 E-mail: fboxk@hotmail.com
Adress: Str. Agim Ramadani no: 43, House of Sport I flour no3, 10000 Pristina, Kosova
NLB Bank No: 1701001010850503